<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi specifik i kësaj lënde është që studentët e këtij profili edukativo-arsimor të arrijnë atë nivel të njohurive gjuhësore dhe të një vokabulari të tillë që do të ishte i nevojshëm për punën e tyre në të ardhmen si dhe për avancimin e aftësive të tyre studimore për specializime të mëtuqjeshëm në fusha të ngjashme profesionale.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët do të jenë në gjendje: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të përdorin fjalor dhe literaturë profesionale</li> <li>2. Të shpjegojnë tema të fushës së tyre</li> <li>3. Të identifikojnë shprehjet shkencore në njësinë mësimore</li> <li>4. Të krahasojnë dhe të vlerësojnë temat që janë zhvilluar gjatë procesit mësimor.</li> </ol>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/Javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	6	6
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume, seminare	2	3	6
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	8	16
Përgatitja përfundimtare për provim	3	2	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	4	8
Projektet, prezantimet ,etj	2	4	8
<b>Total</b>			<b>125</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<i>Kryesisht metoda komunikative - interaktive</i>		
<b>Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik</b>	<b>Pjesa teorike (%)</b>		<b>Pjesa praktike (%)</b>
	<b>50%</b>		<b>50%</b>
<b>Literatura bazë:</b>	[1]. Sarah Cunningham, Peter Moor – Cutting Edge, Longman [2]. Lindsay White, Neë Interchange – OUP [3]. Liz &John Soars, Headway, Oxford University Press		

<b>Titulli i lëndës:</b>		<b>GJUHË GJERMANE II</b>		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Në lëndën <i>Gjuhë gjermane I</i> gjatë ligjëratave do të mësohen pjesë nga gramatika e gjuhës gjermane që janë në shërbim të komunikimit dhe që janë të lidhura ngushtë me temat që do të trajtohen gjatë semestrit. Temat që do të zhvillohen do të jenë kryesisht nga libri bazë i kësaj lënde "<i>Themen Aktuell 1</i>" leksionet 1-5.</p> <p>Gjatë ushtrimeve do të ushtrohen dhe do të zhvillohen sistematikisht katër shkathtësitë kryesore të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit, por edhe gramatika e fjalori (vokabulari) përmes temave të librit "<i>Themen Aktuell 1</i>". Ky libër është i ndarë në leksione të cilat janë të organizuara në mënyrë tematike. Temat janë të zgjedhura nga jeta e përditshme dhe përkohë me interesimet e nxënësve fillestarë. Përmes këtyre temave thellohen njohuritë dhe shkathtësitë ekzistuese në komunikimin e përditshëm. Studentët mësojnë si të reagojnë në situata të ndryshme komunikative me njerëz, për profesionet e tyre, për nevojat themelore jetësore, etj. Për të ushtruar shkathtësinë e të dëgjuarit, gjatë ushtrimeve do të përdoren edhe CD-të me tema nga libri bazë.</p>			
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Lënda " <i>Gjuhë Gjermane I</i> " ka për qëllim të ushtruarit e shkathtësive gjuhësore, të cilat i shërbejnë studentëve për të komunikuar në gjuhën gjermane, për të lexuar, por, edhe për të shkruar tekste të shkurtëra, mundësisht pa gabime.			
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të shkruajë tekste të ndryshme shumë të shkurtra mundësisht duke iu përmbajtur rregullave të drejtshkrimit dhe të strukturës së fjalisë së gjuhës gjermane</li> <li>të lexojë drejtë duke ju përmbajtur rregullave të drejtshqiptimit të gjuhës gjermane si dhe të kuptojë tekstet e lexuara</li> <li>të dëgjojë dhe të kuptojë biseda e tekste të caktuara, por të thjeshta në gjuhën gjermane</li> <li>të mësojë fjalët e vokabularit që është përdorur në librin "<i>Themen Aktuell 1</i>"</li> <li>të dijë gramatikën e shpjeguar në librin "<i>Themen Aktuell 1</i>", e cila është në shërbim të komunikimit</li> <li>të aftësohet të shfrytëzojnë strukturat dhe rregullsitë e gjuhës gjermane për përdorimin më të vetëdijshëm të gjuhës amtare, që t'i zhvillojnë në mënyrë të pavarur më tutje aftësitë e fituara në gjuhën gjermane si dhe mbi këtë bazë të mësojnë gjuhë të tjera të huaja.</li> </ul>			
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënësve të studentit)</b>				
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>	
Ligjërata	2	15	30	
Ushtrime teorike	1	15	15	
Punë praktike				
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	3	3	
Detyra të shtëpisë	1	5	15	
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	30	
Përgaditja përfundimtare për provim	7	2	14	
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	4	8	
Projektet,prezentimet ,etj	2	5	10	
Total			<b>129</b>	
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Lënda realizohet përmes ligjëratave dhe ushtrimeve gjuhësore. Përmes metodës bashkëbiseduese – punohet në mënyrë individuale, në çifte dhe në grupe. Duke qenë se metodat më të reja të mësimdhënies së gjuhëve të huaja thonë se mënyra më e mirë e mësimin të gjuhëve të huaja bëhet përmes komunikimit, kështu edhe zhvillohen orët. Në të njëjtën formë është i konceptuar edhe libri me të cilin kam zgjedhur të punojmë. Pra, mënyra e mësimdhënies është ajo me studentin në qendër me ç' rast ata janë tërë kohën të angazhuar dhe të kyqur në bashkëbisedë. Në orët e ushtrimeve punohet me libër tjetër të veçantë ku njohuritë e marra nga ligjëratat, studentët i përsërisin me shkrim dhe njëkohësisht i bëjnë edhe ushtrimet gramatikore.			
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Testi gjysëmsemestral <b>35%</b>, Testi final <b>50%</b>, Detyrat dhe aktiviteti në klasë gjatë semestrit <b>8%</b>, Pjesëmarrja <b>7%</b></li> </ul>			
<b>Literatura bazë:</b>	<p>[1]. „<i>Themen Aktuell 1</i>”, Kursbuch, Lektion 1-5, Hueber Verlag, München, 2007</p> <p>[2]. „<i>Themen Aktuell 1</i>”, Arbeitsbuch, Lektion 1-5, Hueber Verlag, München, 2007</p>			

<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>REZISTENCA E MATERIALEVE</b>		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Njohuri të përgjithshme mbi lëndën, momentet e inercisë të seksioneve planare, pastaj, trajtimi i ndemjeve themelore- ndemjes aksiale, rrëshqitjes, përdredhjes, përkuljes si dhe atyre të përbëra-përkuljes së pjerrët, epjes, etj. Së fundi, shtjellohen metodat e energjisë së deformimit në zgjidhjen e problemeve të rezistencës së materialeve dhe sistemet statikisht të papërcaktuara në përkulje sipas metodës së punës së deformimit, metodës së Morit dhe metodës së Vereshqaginit.		
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Përgaditja e studentëve me qëllim të kalkulimeve të ndryshme të detajeve të konstruksioneve sipas kushteve të soliditetit, etj.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që të bëjë analizën e sforcimeve dhe deformimeve në probleme të ndryshme në lëminë e inxhinierisë mekanike, pastaj, në konstruksione të ndryshme të eksponuara ndemjeve të nduarduarta, të bëjë dimensionimin e detajeve të ndryshme të atyre konstruksioneve dhe së fundi, të njeh metodat e ndryshme për zgjidhjen e sistemeve statikisht të papërcaktuar.		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1/2	10	5
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume,seminare	2	4	8
Detyra të shtëpisë	2	10	20
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	10	40
Përgaditja përfundimtare për provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	5	10
Projektet,prezentimet ,etj	0	0	0
<b>Total</b>			<b>155</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata me anë të prezentimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime.		
<b>Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik</b>	<i>Pjesa teorike (%)</i>		<i>Pjesa praktike (%)</i>
	<b>60%</b>		<b>40%</b>
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Xh. Perjuci, Rezistenca e Materialeve I, Prishtinë, 1994.</li> <li>2. Xh. Perjuci, Rezistenca e Materialeve II, Prishtinë, 1994.</li> <li>3. Xh. Perjuci, Rezistenca e Materialeve I-Përmbledhje detyrash të zgjidhura, Prishtinë, 1998.</li> <li>4. Xh. Perjuci, Sh.Buza, Rezistenca e Materialeve II-Përmbledhje detyrash të zgjidhura, Prishtinë, 1998.</li> <li>5. Xh. Perjuci, R. Likaj, Rezistenca e Materialeve -Manual, Prishtinë, 2002.</li> <li>2. Hibbler R. C., Mechanics of Materials,2004.</li> </ol>		

<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>MEKANIKA E FLUIDEVE</b>		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Njohuri për vetitë fizike të fluideve. Statikën e fluideve, Ligjet fizike të staikes së fluideve. Forca e presionit në sipërfaqet plane dhe kurbëzuar. Kinematika e fluideve. Dinamika e fluideve. Ekuacioni i Bernoullit. Regjimet e lëvizjes së lëngjeve. Humbjete e energjisë së lëngut gjatë lëvizjes. Rrjedhja e qëndrueshme e lëngjeve nëpër tuba. Goditja hidraulike nëpër tuba të thjeshtë, Rrjedhja e lëngut nëpër vrima, Veprimi dinamik i rrymave. Teoria e ngajshmerisë dhe analiza dimensionale.		
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Aftësimi i studentëve nga lëmia e Mekanikës së fluideve		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<i>Studentët do të përvojshojnë:</i> Ndikimin e presionit dhe temperaturës në vetit fizike të fluideve. Instrumentet matëse të presionit. Zbatimin e ligjit të Arkimedit. Zbatimin e ekuacionit të Bernoullit. Karakteristikat e regjimit laminar dhe turbulent. Humbjet lokale dhe gjatësore gjatë rrymimit të fluidit. Shpejtësia e përhapjes së goditjes hidraulike dhe mënjanimi i goditjeve hidraulike. Llogaria hidraulike e hundëzave. Forca dinamike e rrymës. Kriteret e ngajshmerisë gjeometrike, kinematike dhe dinamike.		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	8	8
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume,seminare	3	3	9
Detyra të shtëpisë	3	15	45
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	2	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	4	8
Projektet,prezentimet ,etj	0	0	0
<b>Total</b>			<b>172</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata me anë të prezantimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime		
<b>Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik</b>	<b>Pjesa teorike (%)</b>		<b>Pjesa praktike (%)</b>
	<b>40%</b>		<b>60%</b>
<b>Literatura bazë:</b>	[1]Prof.dr. Januz Bunjaku, <i>Mekanika e fluideve</i> , Ligjeratat e autorizuar, Prishtinë, 2011. [2] Munson/Young/Okiishi <i>FUNDAMENTALS OF FLUID MECHANICS</i> , USA 2002 [3] Mr.inxh.XHEMAJL FEJZULLAHU, Dr.inxh.FEJZULLAH KRASNIQI, <i>HIDRAULIKA DHE TERMODINAMIKA</i> , Prishtinë, 1988.		

<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>MATEMATIKA E APLIKUAR ME STATISTIKË</b>		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Lënda ka të bëjë me njohuri nga metodat numerike, probabiliteti dhe statistika që janë të nevojshme për lehtësimin e fitimit të njohurive nga lëndët tjera dhe zbatimin e njohurive nga keto fusha në inxhinjeri		
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Fitimi dhe thellimi i dijes në disiplinat matematike: metodat numerike, probabiliteti dhe statistika</li> <li>Fitimi i shkathtësive të nevojshme që në mënyrë efektive dhe me suksese të studiohen edhe kurset tjera që studiohen në shkenca e makinerise</li> </ol>		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Pas përfundimit të këtij kursi /lënde mësimore/ studenti do të jetë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> <li>- reflektojë mbi rendesine e statistikes ne fushen e inxhinierise</li> <li>- prezantoje saktë tabelat dhe grafet statistikore</li> <li>- jete ne gjendje te gjeje moden, medianen, mesin aritmetik etj</li> <li>- gjeje variacionet e te dhenave, analizat statistikore dhe te kalkuloje indeksat</li> <li>- aplikojë njohurine nga metodat numerike ne fushen e inxhinierise</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	20	20
Përgaditja përfundimtare për provim	1	10	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	4	8
<b>Totali</b>			<b>124</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Leksione te avancuara, diskutime, punë e pavarur individuale, punë në grupe etj		
<b>Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik</b>	<i>Pjesa teorike (%)</i>		<b>Pjesa ushtrimeve ose praktike (%)</b>
	<b>50%</b>		<b>50%</b>
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Richard L. Burden, J. Douglas, Numerical Analysis,</li> <li>Higher Engineering Mathematics by B. S. Grewal</li> </ol>		

<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>BAZAT E KIMISË</b>			
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Bazat e Kimisë merret me aplikimin e Kimisë në inxhinieri dhe industri. Ligjëratat në Bazat e Kimisë do të përqendrohen në: strukturën atomike dhe tabelën periodike të elementeve, lidhjet kimike (jonike-, kovalente-, lidhjet metalike), gjendjet e materies (gazet, lëngjet, trupat e ngurtë), reaksionet kimike (ekuacionet e reagimit, stochiometria, termodinamika, kinetika), komponimet kimike (solucionet, përzierjet e lëngshme, lidhjet), acidet dhe bazat (forca e lidhjes acid/bazë, pH, titrimet), reagimet Redox, elektrokimia (numri i oksidimit, seritë elektrokimike, celulat voltaike, elektroliza, korrozioni), kimi e lëndëve djegëse dhe djegies së brendshme, metalurgjia.			
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Qëllimi lëndës është të aftësojë studentin me njohuritë mbi bazat e kimisë			
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Pas përfundimit të këtij kursi /lënde mësimore/ studenti do të jetë në gjendje të: Të ofrojë njohuri bazike nga kimia e përgjithshme dhe të kuptojë parimet fundamentale të structures dhe reaktiviteti të komponimeve relevante organike dhe inorganike.			
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>				
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë</b>	<b>Javë</b>	<b>Total</b>
Ligjëratat	2		15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2		15	30
Punë praktike				
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2		5	10
Ushtrime në teren				
Kollokfiume,seminare	3	2		4
Detyra të shtëpisë	1		15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2		12	24
Përgaditja përfundimtare për provim	2	3		6
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	2		6
<b>Totali</b>				<b>125:25 = 5</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Leksione te avancuara, diskutime, punë e pavarur individuale, punë në grupe etj			
<b>Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik</b>	<i>Pjesa teorike (%)</i>		<i>Pjesa ushtrimeve ose praktike (%)</i>	
	<b>50%</b>		<b>50%</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	[1]. Univ.-Prof. Dr. H. Stüger: Chemie, Institut für Anorganische Chemie, Technische Universität Graz, 2009 [2]. C.E.Mortimer, "Chemie", G.Thieme Verlag Stuttgart, [3]. T.L.Brown/H.E.Le May, "Chemie", Verlag Chemie Weinheim, [4]. P.W.Atkins/J.A.Beran, "Chemie, einfach alles", Verlag Chemie [5]. L.Jones/P.W.Atkins, "Chemistry, Molecules, Matter, and Change", W.H. Freeman & Comp. 1999 [6]. K.Schwister, "Taschenbuch der Chemie", Fachbuchverlag Leipzig-Köln			

<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>MEKANIKA TEKNIKE II</b>		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Njohuri nga lëmia e kinematikës së pikës materiale dhe kinematikës së trupit të ngurtë. Shqyrtimi i lëvizjes së përbërë të pikës materiale. Në pjesën e dytë ofrohen njohuri nga studimi i lëvizjes së trupave në aspektin e dinamikës, pra duke marrë parasysh veprim e forcave në lëvizje. Në pjesën e fundit shqyrtohen lëkundjet drejtvizore të pikës-trupit nën veprimin e ngacmimeve të ndryshme dhe rezistencave të ndryshme.		
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Njohja dhe thëllimi i diturisë mbi kinematikën dhe dinamikën e pikës materiale dhe trupit të ngurtë. Njohuri të mjaftueshme mbi ligjet – parimet e Kinematikës dhe Dinamikës si pjesë e mekanikës aplikative. Materia që shtjellohet në këtë kurs paraqet vazhdimësi të kursit nga Mekanika Teknike I.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Studentët pas përfundimit me sukses të këtij moduli, do: 1. Të dijnë për lëvizjen vijëpërkulur dhe atë të përbërë të pikës 2. Të shqyrtojnë lëvizjen në rrafsh të trupit të ngurtë 3. Të dijnë për dinamikën e pikës së lirë dhe jo të lirë 4. Të shqyrtojnë lëvizjen e përbërë të pikës në aspektin dinamik 5. Të mund të analizojë lëkundjet drejtvizore të pikës materiale		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume,seminare	5	2	10
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetjak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	10	40
Përgatitja përfundimtare për provim	20	1	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	5	1	5
Projektet, prezantimet ,etj	0	0	0
<b>Totali</b>			<b>150</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata me anë të prezantimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime etj.		
<b>Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik</b>	<b>Pjesa teorike (%)</b>		<b>Pjesa praktike (%)</b>
	<b>40%</b>		<b>60%</b>
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	[1]. Dr. sc. Ahmet Shala, Mekanika Teknike II, ligjërata të autorizuara, Prishtinë 2007-2015 [2]. Dr. sc. Ahmet Shala: Përmbledhje detyrash të zgjidhura nga Mekanika teknike II, Prishtinë, 2007		

<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>DETALET E MAKINAVE</b>		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Tolerancat, llojet dhe sistemet e vendosjeve. Llojet e ngarkesave. Filetot dhe lidhjet filetoze. Llogaritjet e transmetuesve filetor dhe bulonave të grupeve të ndryshme. Sustat, llojet dhe përdorimi. Transmetuesit me rripa dhe zinxhirë. Transmetuesit me dhëmbëzorë, qëndrueshmëria e dhëmbëzorëve. Boshtet dhe akset, kalkulimi paraprak dhe përfundimtarë i tyre. Dorëzat, përdorimi dhe kalkulimi. Kushinetat -llojet dhe kalkulimi i tyre. Lidhëset, llojet dhe kalkulimi.		
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Njohja e studentëve me Detalet e makinave, të cilat përdoren në makina të ndryshme në përgjithësi. Kursi analizon në veçanti detalet, të cilat përdoren në konstrukcionet e makinave të ndryshme industriale dhe mjeteve ndihmëse (mekanizmat e ngarkim – shkarkimit dhe transportit të mallrave në repartet industriale etj).		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Detalet e makinave në përgjithësi t'i kuptojnë për kah forma, lloji, materiali dhe funksioni.</li> <li>- T'i kuptojnë mënyrat e veprimit të ngarkesave në detale të ndryshme gjatë funksionimit të makinave përkatëse.</li> <li>- Të bëjnë kalkulimin e detaleve nën veprimin e ngarkesave përkatëse.</li> <li>- Të dijnë të aplikojnë mënyrat e caktimit të shkallëve të sigurisë dhe afatshërbimit të detaleve vitale të makinave.</li> <li>- Për pjesët e studjuara në kurs të dijnë të zbatojnë metodat e përdorimit dhe mirëmbajtjes së makinave sipas rregullave teknike.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	5	5
Kontaktet me mësuesin/konsultimet	15	12	3
Ushtrime në teren	1	5	5
Kollokfiume,seminare	2	3	6
Detyra të shtëpisë	8	3	24
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgaditja përfundimtare për provim	10	2	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet, prezentimet, etj.	0	0	0
<b>Totali</b>			<b>161</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata me anë të prezentimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime grafike, teste, diskutime.		
<b>Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik:</b>	<b>Pjesa teorike (%)</b>		<b>Pjesa praktike (%)</b>
	<b>70</b>		<b>30</b>
<b>Literatura bazë:</b>	[1]. Dr. sc. Nijazi Ibrahim, “Detalet e Makinave I”, Prishtinë 2004, [2]. Dr. sc. Nijazi Ibrahim, “Detalet e Makinave II”, Prishtinë 2006, [3]. Dr. sc. Nijazi Ibrahim, “Përmbledhje detyrash të zgjidhura nga Detalet e Makinave I, II”, Prishtinë 2007. [4]. Dr.sc. Azem Kyçyku, “Udhëzimet e detyrave grafike nga Detalet e Makinave “ (Praktikum), Prishtinë 2010.		



<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>TERMODINAMIKA</b>		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Njohuri baze per termodinamiken, trupi i punes-real dhe ideal, puna dhe energjia,parametrat e gjendjes termodinamike,ndryshimet e gjendjes,politropa dhe rastet e veçanta, ligjet themelore te termodinamikes, ciklet termodinamike, centralet termike, transmetimi i nxehtesise.		
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Aftësimi i studentëve nga lëmia e termodinamikes		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Njohurit elementare per termodinamiken,analizat e gjendjes termodinamike dhe ndryshimet e tyre,gazrat reale dhe idealizimi i tyre,ligjet e termodinamikes .entalpia,entropia,eksergjia,reversibiliteti dhe ireversibiliteti,konduksioni ,konveksioni dhe rrezatimi termik.		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mesimdhënësin/konsultimet	1	8	8
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume,seminare	3	3	9
Detyra të shtëpisë	3	15	45
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	3	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	4	8
Projektet,prezentimet ,etj	1	8	8
<b>Total</b>			<b>185</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata me anë të prezantimeve, detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime		
<b>Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik</b>	<i>Pjesa teorike (%)</i>		<b>Pjesa praktike (%)</b>
	<b>50%</b>		<b>50%</b>
<b>Literatura bazë:</b>	[1]. 1.Demneri,I. etj(2003): Termodinamika.UPT, Tiranë [2]. Krasniqi,F,Muriqi,A.(1995):Permbledhje detyrash nga termodinamika, FIM, Prishtinë		

<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>MEKANIKA E APLIKUAR E FLUIDEVE</b>		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Njohuri për Veshtullmatësin, Sforcimi në rrymim. Matësi i tensionit të gjakut. Matësi Burdon. Hidrometri, Stabiliteti i modelit lundrues. Rrjedhja nga rezervuari, Hundëza e Venturit. Rrymorët. Ekuacioni i kontinuitetit. Lëvizja këndore dhe deformacioni. Numri i Reynolds-it. Matësi i prurjes fluidale, Matësi ujit. Rrjedhja nëpër trupat e zhytur Rrjedhja e fluidit të shtypshëm. Turbina nën veprimin e erërave. Ekuacioni i Navier -Stokes		
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Aftësimi i studentëve nga lëmia e Tubacioneve		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Menyrën e matjeve të presionit, Veshtullin. Forcen hidrostatike në penden Hoover. Zbatimin e ekuacionit të kontinuitetit dhe Bernullit. Fushen e shpejtësive. Analizen dimensionale dhe modelimin. Profilin e shpejtësive për rrymimin laminar/ turbulent. Mënyren e matjes së rrjedhjes fluidale. Matien e shpejtësisë me tubit Pito. Forcen dinamike të fluidit.Njohuri të përgjithshme për ekuacionin e Navier-Stokes-it. Kushtet kufitare.		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	8	8
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiime,seminare	3	3	9
Detyra të shtëpisë	3	15	45
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	2	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	4	4
Projektet,prezentimet ,etj	0	0	0
<b>Total</b>			<b>168</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata me anë të prezentimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime		
<b>Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik</b>	<b>Pjesa teorike (%)</b>		<b>Pjesa praktike (%)</b>
	40%		60%
<b>Literatura bazë:</b>	[1] Prof.dr. Januz Bunjaku, <i>Mekanika e aplikuar e fluideve</i> , Ligjeratat e autorizuar, Prishtinë, [2] Munson/Young/Okiishi, <i>Fundamentals Of Fluid Mechanics</i> , USA 2002 [3] Mr.inxh.XHEMAJL FEJZULLAHU, Dr.inxh.FEJZULLAH KRASNIQI, <i>HIDRAULIKA DHE TERMODINAMIKA</i> , Prishtinë, 1988		

<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>LËNDËT DJEGËSE KONVENCIONALE</b>		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>- Konceptet themelore për burimet e energjive të papërsëritshmeve. Njohja me karakteristikat për lëndët djegëse të ngurta, të lëngëta, të gazta si dhe me pajimet për realizimin e proceseve dhe cikleve për përfitimin e energjisë elektrike dhe termike.</p> <p>- Konceptet themelore për burimet e energjive të ripërtëritshme si dhe pajimet për përfitimin e energjive nga energjia e erës, të burimeve ujore dhe solare.</p> <p>- Njohuri për shtëpitë me efektivitet energjetik dhe transformimi i energjisë dhe efikasiteti energjetikë</p> <p>- Parashtrimin dhe hartimin e problemeve inxhinierike të lidhura me burimet e energjisë si dhe zhvillimin e studimeve të pavarura inxhinierike.</p>		
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Aftësimi i studentëve nga lëmia e burimeve të energjisë.		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p><i>Studentët do të përvojnë:</i></p> <p>Njohuritë profesionale mbi studimin e mundësive për shfrytëzimin e burimeve të energjive konvencionale – të papërtëritshmeve (burimet fosile dhe nukleare) e sidomos nga energjitë alternative - të ripërtëritshmeve (energji e erës, hidroenergji, energji e biomasës, energji solare, etj).</p>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	8	8
Ushtrime në teren	5	2	10
Kollokfiume,seminare	2	3	6
Detyra të shtëpisë	2	10	20
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	5	2	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	4	8
Projektet,prezantimet ,etj	0	0	0
<b>Total</b>			<b>154</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata me anë të prezantimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime		
<b>Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik</b>	<b>Pjesa teorike (%)</b>		<b>Pjesa praktike (%)</b>
	<b>40%</b>		<b>60%</b>
<b>Literatura bazë:</b>	<p>[1] Prof.Xhevat Berisha: <i>Burimet e Energjisë</i>, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike Prishtinë, Ligjërata të autorizuara, 2012.</p> <p>[2] S.Thodhorjani, B.Cela, J.Hanxhari, V.Jorgji: <i>Burimet e Energjisë</i>, SHLBU, Tiranë, 2008.</p>		

<b>Titulli i lëndës:</b>		<b>BAZAT E ENERGJISË SË RIPËRTËRISHME</b>		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Në kuadër të kësaj lënde studentët do të fitojnë njohuri në lidhje me kërkesat për energji, sistemet për plotësimin e nevojave energjetike, resurset bazike të energjisë së ripërtërishme (solare, të erës, ujit dhe gjeotermale), teknologjinë e shfrytëzimit të burimeve të ripërtërishme energjetike (sistemet fotovoltaike, solartermike, hidrike, termopompat), mënyrat e ruajtjes së energjisë, analizën termodinamike dhe ekonomike e sistemeve me energji të ripërtërishme			
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Aftësimi i studentëve në fushën e Burimeve të ripërtërishme të energjisë			
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Të bëjnë vlerësimin e kërkesave për energji, ti diskutojnë problemet në lidhje me furnizimin me energji, ti përshkruajnë sistemet themelore energjetike, të bëjnë listimin dhe përshkrimin e burimeve të ndryshme të energjisë së ripërtërishme, ti përshkruajnë parimet themelore të funksionimit të teknikës së shfrytëzimit të energjisë së ripërtërishme, ti njohin konceptet bazike për ruajtjen e energjisë, të bëjnë analizën termodinamike të proceseve të shndërrimit të energjisë së ripërtërishme dhe të bëjnë vlerësimin ekonomik të sistemeve me energji të ripërtërishme			
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>				
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>	
Ligjërata	2	15	30	
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30	
Punë praktike	3	1	3	
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	8	8	
Ushtrime në teren	0	0	0	
Kollokfiume,seminare	0	0	0	
Detyra të shtëpisë	3	10	30	
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45	
Përgaditja përfundimtare për provim	4	4	16	
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	4	8	
Projektet, prezentimet ,etj	0	0	0	
<b>Total</b>			<b>170</b>	
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata me anë të prezentimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime			
<b>Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik</b>	Pjesa teorike (%)		Pjesa praktike (%)	
	40%		60%	
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. V. Wesselak, Th. Schabbach: <i>Regenerative Energietechnik</i>, Springer, 2009.</li> <li>2. M. Kaltschmitt, W. Streicher, A. Wiese: <i>Renewable Energy</i>, Springer, 2007.</li> <li>3. AP: <i>Renewable Energy Focus Handbook</i>, Elsevier, 2009.</li> </ol>			

<b>Titulli i lëndës:</b>		<b>MENAXHIMI I PROJEKTEVE</b>		
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	Përkufizimi i Menaxhimit teknik të projekteve si disiplinë e planifikimit, organizimit, sigurimit, menaxhimit kryesor, dhe kontrollit të burimeve teknike për të arritur qëllimet specifike. Përkufizimi i këtij termi si një përpjekje e përkohshme me një fillim dhe fund të përcaktuar (zakonisht kohë e kufizuar, dhe e kufizuar shpesh nga financimi apo te rezultateve), të ndërmarra për të përmbushur qëllimet dhe objektivat unike, zakonisht për të sjellë ndryshime të dobishme apo shtuar vlerën. Identifikimi i natyrës së përkohshme të projekteve të cilat qëndrojnë në kontrast me biznesin (ose me Operacione), të cilat janë të përsëritura, aktivitete të përhershme, ose gjysmë-funksionale të përhershme për të prodhuar produkte ose shërbime. Përdorimi në praktikë, ti menaxhimit dhe zhvillimit të aftësive të ndryshme teknike dhe strategjive të menaxhimit.			
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Aftësimi i studentëve nga lëmia e Menaxhimit teknik të projekteve			
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	Sfida kryesore e menaxhimit të projektit është për të arritur të gjitha qëllimet dhe objektivat e projektit duke nderuar kufizimet formuar. Kufizimet primare janë, fushëveprimi kohën, cilësinë dhe buxhetin. Mesme-dhe më ambicioze-sfidë është që të zgjedh alokimin e inputeve të nevojshme dhe integrimin e tyre për të përmbushur objektivat e para-përcaktuar.			
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>				
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>	
Ligjërata	2	15	30	
Ushtrime teorike/laboratorike	0	0	0	
Punë praktike	1	2	2	
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	14	14	
Ushtrime në teren	0	0	0	
Kollokviume,seminare	3	3	9	
Detyra të shtëpisë	3	15	45	
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	5	4	20	
Përgatitja përfundimtare për provim	2	4	10	
Koha e kaluar në vlerësim (teste,provim final)	2	4	8	
Projektet,prezentimet ,etj	0	0	0	
<b>Total</b>			<b>152</b>	
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata me anë të prezantimeve, ushtrime me detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime			
<b>Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik</b>	Pjesa teorike (%)		Pjesa praktike (%)	
	70%		30%	
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Project Management: A Systems Approach to Planning, Scheduling, and Controlling by Harold Kerzner,2009, John Wiley and Son.</li> <li>2. Absolute Beginner's Guide to Project Management (2nd Edition) by Greg Horine,2009,Que Publishing.</li> <li>3. The Principles of Project Management (Site Point: Project Management) by Meri Williams.</li> </ol>			

<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>MBROJTJA E AMBIENTIT</b>		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Njohuri me ambientin dhe ndotjen,llojet e ndotjeve,analiza dhe mundesia e zvogëlimit dhe evitimit te tyre,ndotja nga djegia,ndotja nga Centralet termike,ndotja nga komunikacioni, LCA-jetgatesia e nje produkti,efekti serre,ndotja akustike,ndotja radioaktive,ndotja biologjiker ,ndotja termike.		
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Aftësimi i studentëve nga lëmia e Mbrojtja e ambientit		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<i>Studentët do të përvoetësojnë:</i> Njohurit elementare per ndotjen,analiza e përgjithshme e ndotesave ne ambient, mundesia e redukimit te ndotesave,ndikimet urbane,lokale dhe globale te pollutantve,emisioni dhe imisioni i pollutantve,ngrohja globale dhe ndikimi i dyoksidit te azotit,rrezatimi elektromanjetik,zhurma dhe matjet dhe llogaritja e ndotesave.		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	0	0	0
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin/ konsultimet	1	8	8
Ushtrime në teren	1	8	8
Kollokfiume,seminare	3	3	9
Detyra të shtëpisë	3	15	45
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	2	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	4	8
Projektet,prezentimet ,etj	1	8	8
<b>Total</b>			<b>158</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata me anë të prezentimeve, detyra dhe shembuj konkret, punime seminarike, teste, diskutime		
<b>Raporti në mes të studimit teorik dhe praktik</b>	<i>Pjesa teorike (%)</i>		<b>Pjesa praktike (%)</b>
	<b>90%</b>		<b>10%</b>
<b>Literatura bazë:</b>	[1]. Muriqi, Ali,(2008): Mbrojtja e ambientit,(ligjerata te autorizuara), FIM,Prishtinë		

<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>ELEKTROTEKNIKA</b>		
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Kuptimet e përgjithshme mbi elektricitetin. Llojet dhe shpërndarja e ngarkesës. Ligji i Kulonit. Fusha elektrike, potenciali dhe tensioni elektrik, përçuesit dhe izolatorët. Kapaciteti elektrik dhe kondensatorët. Elementet e qarkut elektrik, burimet e pavarura. Qarqet e rrymës së vazhduar. Ligji i Omit. Ligji i parë dhe ligji i dytë i Kirhofit, Ligji i Xhaulit. Gjeneratorët ekuivalent të tensionit dhe të rrymës. Metodat themelore për llogaritjen e qarqeve elektrike. Akumulatorët. Qarqet e përbëra elektrike. Metoda dhe teoremat: Zbatimi i tyre për zgjidhjen e qarqeve elektrike lineare. Kuptimet themelore mbi magnetizmin. Fusha magnetike, forca elektromagnetike, induksioni magnetik. Fluksi magnetik. Sistemet matëse dhe qarqet matëse, parimi i punës së gjeneratorit. Parimi i funksionimit të motorit të rrymës së vazhdueshme, parimi i punës së transformatorit elektrik. Qarqet e rrymës sinusoidale. Llogaritja e vlerës efektive. Fuqia aktive, reaktive dhe fuqia e plotë. Transmetimi maksimal i fuqisë elektrike në shpenzues. Qarqet trefazore. Shpërndarja e energjisë dhe rrjeti elektrik. Makinat elektrike. Transformatorët, motorët e rrymës sinusoidale dhe motorët njëkahorë. Parimi i punës së makinave elektrike. Siguria nga aspekti elektrik. Pajisjet elektronike.</p>		
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Studentët të fitojnë bazat e trajtimit të problemeve të inxhinierisë elektrike		
